



INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE I KOSOVËS DHE

EKIPI I MJEKËSISË LIGJORE I EULEX-IT

**Një partneritet afatgjatë për kërkimin dhe
identifikimin mjeko-ligjor të personave të zhdukur**

GUSHT 2025



Rreth 1,590 persona, të cilët u raportuan të zhdukur gjatë periudhës 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, janë ende të zhdukur. Familjet e tyre kanë të drejtë ta dinë të vërtetën.

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) është institucioni i vetëm në Kosovë që ofron shërbime mjeko-ligjore për të ndihmuar në ndriçimin e fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur në lidhje me konfliktin e Kosovës, si dhe për menaxhimin e mbetjeve mortore të paidentifikuara.

Ekipi i Mjekësisë Ligjore i EULEX-it (EML) është integruar në IML që nga fillimi i mandatit të tij në vitin 2008, duke punuar së bashku me kolegët vendas dhe duke kontribuar në forcimin e përgjithshëm të kapaciteteve mjeko-ligjore, si dhe duke ofruar ndihmë, veçanërisht nëpërmjet **antropologjisë, arkeologjisë** dhe **kapaciteteve analitike**.



IML dhe EML i EULEX-it, së bashku me autoritetet përkatëse, siç janë Komisioni Qeveritar i Kosovës për Personat e Zhdukur dhe Policia e Kosovës, si dhe partnerët ndërkombëtarë, si Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), **vazhdojnë të jenë të përkushtuar në kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur.**



NJË VIT NË VËSHTRIM

SHTATOR 2024 – GUSHT 2025

ANGAZHIMET PËR KËRKIMIN E PERSONAVE TË ZHDUKUR

Operacione në terren (ditë në terren)

69

Lokacione unike

42

Zhvarrime

13

Vlerësime të lokacioneve

21

Vizita në lokacione

16





SFIDAT TEKNIKE TË PROCESIT TË KËRKIMIT

-  **Burime të pakësuara të
dëshmitarëve/informatorëve të
besueshëm**
-  **Ndryshimet në konfiguracionin e
mjedisit dhe tiparet gjeografike**
-  **Mospërputhje mes informatave
në dispozicion dhe imazheve
ajrore**
-  **Qasje e kufizuar në të dhëna të
sakta**



NJË VIT NË VËSHTRIM

SHTATOR 2024 – GUSHT 2025

ANGAZHIMET PËR IDENTIFIKIMIN E MBETJEVE MORTORE NJERËZORE

Mostra të marra për analizë të ADN-së

54

Identifikime të reja

40

**Persona të zhdukur të
identifikuar**

23

Ri-bashkime

59

Dorëzime

35





SFIDAT TEKNIKE TË PROCESIT TË IDENTIFIKIMIT

- Gjendje jo e mirë e mbetjeve mortore**
- Mostra referente jo-ekzistuese ose të pamjaftueshme të ADN-së nga familjet**
- Persona që nuk janë raportuar kurrë si të zhdukur**
- Identifikime të gabuara**



PO ÇFARË LIDHUR ME MBETJET E PAIDENTIFIKUARA NË MORG?

Në bazë të hulumtimeve të reja për rastet e mundshme të identifikimeve të gabuara dhe identifikimeve të supozuara, u realizua marrja e shënjestruar e mostrave referente nga familjet që nuk i kishin dhënë ato më parë, ose të cilat kishin mostra referente të pamjaftueshme. Në disa raste, u morën gjithashtu mostra shtesë nga mbetjet mortore në morg.

SHTATOR 2024 – GUSHT 2025

23

**RASTE TË ZGJIDHURA TË
MBETJEVE MORTORE TË
PAIDENTIFIKUARA**

13

**IDENTIFIKIME
TË REJA**

10

RI-BASHKIME

3

**RASTE TË IDENTIFIKIMIT
TË GABUAR**



Familjet e personave të zhdukur mund ta ndihmojnë punën e IML-së duke dhënë mostra referente nëse këtë nuk e kanë bërë, si dhe duke dhënë informata lidhur me personin e zhdukur ose lidhur me ngjarjen e zhdukjes.

Familjet mund të na kontaktojnë gjithashtu për ndonjë sqarim apo kërkesë për informata.

KONTAKTE TË DOBISHME

INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

+383 (0) 38 200 18 555

info@mjekesialigjore-ks.com

EULEX

+383 (0) 49 78 4111

info@eulex-kosovo.eu